



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 87, datë 30.03.2021

MBI

**HEQJEN E LICENCËS NR. 59, SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË “ERS-08”
SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 63, DATË 13.06.2008, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 7, 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/4 prot., datë 24.03.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 33, datë 04.02.2021, vendosi:
 1. *Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 63, datë 13.06.2008, i ndryshuar.*
 2. *Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., nr. 59, seria NPM08P.*
 3. *Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.*
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të bordit nëpërmjet shkresës nr. 306, datë 11.02.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.
- Nuk rezulton që shkresa e dërguar të jetë kthyer mbrapsht nga posta, ndaj konsiderohet se shoqëria ka marrë dijeni për vendimmarrjen e bordit të ERE-s.
- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE as informacion dhe as dokumentacion dhe nuk ka marrë masa për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “c”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se:
Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:
c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.
- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë licencën nr. 59, seria NPM08, dhënë shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 13.06.2008, i ndryshuar.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ERS-08” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI